



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1256/5 prot.

Datë 07.05.2026

V E N D I M
Nr. 599/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07 .05.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing Distribution” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” , me Nr. REF- 82530-04-20-2026, me objekt: “Blerje Materiale Pastrimi” me fond limit 3,327,400.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 04-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Kuçovë

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” , me Nr. REF- 82530-04-20-2026, me objekt: “Blerje Materiale Pastrimi” me fond limit 3,327,400.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 04-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Kuçovë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “MIA Group Albania” SHPK me NIPT M51310002C dhe adresë: *Rruga Sami Frasheri, Nd 23, H 10, Ap 21,1019, Njesia Nr 5, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Kuçovë, *me adresë: Blloku Nr.1 Lagja “Tafil Skendo”.*

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe Rregullat e Prokurimit Publik të ndryshuara.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21-04-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF- 82530-04-20-2026, me objekt: “Blerje Materiale Pastrimi” me fond limit 3,327,400.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 04-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Kuçovë.

II.2. Në datën 23.04.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr.1256/2026 protokoll, dhe protokolluar pranë KPP, datë 24.04.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6577, e operatorit ekonomik “MIA Group Albania” SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumentave të tenderit.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4 Me shkresën me nr. 1833 prot., me datë 30.04.2026, protokolluar me tonën nr. 1256/1 prot., me datë 30.04.2026 (shkresë e ardhur dhe në sistemin elektronik) si edhe nëpërmjet shërbimit postar me nr. 1256/2 prot., datë 07.05.2026, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë komisionit të prokurimit publik, trajtimin e ankesës, ku ka vendosur pranimin pjesërisht të saj si në vijim:

... [Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik ...]

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues ekonomik “MIA Group Albania” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1. 2. Me shkresën me nr. 1833 prot., me datë 30.04.2026, protokolluar me tonën nr. 1256/1 prot., me datë 30.04.2026 autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, trajtimin e ankesës, ku ka vendosur pranimin pjesërisht të saj si në vijim:

... [Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik ...]

III.1.3. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 114 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.5. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

- i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;
- ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë

paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.6. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës me nr. 1833 prot., me datë 30.04.2026, protokolluar me tonën nr. 1256/1 prot., me datë 30.04.2026 (autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik, për trajtimin e ankesës, si dhe ku ka vendosur pranimin pjesërisht të saj si në vijim:

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për pjesën e pranuar të ankesës paraqitur nga operatori ekonomik “MIA Group Albania” SHPK, dhe të vijojë shqyrtimin për pjesën e tjetër.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “MIA Group Albania” SHPK , me arsye se :

... [2-Te behen ndryshime mbi kriterin 2.3.3 ku theksohet qe OE te kete 2 punonjes,nje te jete punetor per shperndarjen e mallrave dhe nje prej tyre shofer. Bejme me dije se ne si OE nuk kemi pse te ngarkohemi me punetore shtese persa kohe nuk dime nese shpallemi fitues nga kjo procedure apo jo.E gjejme me vend qe ky kriter eshte i tepruar .Gjithashtu ne Kompani ne nuk mund ta ngarkojme me punetore shtese per sa kohe ne punetoret i marim me kontrata afatshurta duke plotesuar cdo nevojte te Autoritetit ne cfare do kohe qe na kerkohet.Gjithsesi edhe nese nuk behen ndryshime te na kerkohet si OE qe ky kriter te behet i plotesushem mbash shpalljes te vleresimeve,pra nga momenti i dorezimit te dokumentacionit e ne vashdim te kerkohen punetoret ne list pagesa]..., Komisioni i prokurimit publik vë re se,

III.2.1. Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.3 Shtojca 7 “ Kriteret e vecanta”, ka parashikuar kriterin si në vijim :

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues, për realizimin me sukses kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 2 (dy) – persona që të figurojnë në listëpagesat e shoqërise për të paktën muajn e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, ku nga këta 1(një) duhet të jetë shoferë i pajisur me lejen e drejtimit, si dhe 1 (një) punonjës ndihmës, për shpërndarjen e mallrave në ambientet e caktuara prej autoritetit kontraktor.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.2.3. Ndëkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”,

parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.2.5. Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

III.2.6 Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkuluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

Në rastin konkret, referuar ankeses se operatorit ekonomik, si dhe nga shqyrtimi i kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike të dokumenteve të tenderit, Komisioni gjykon, se kërkesa që Operatori ekonomik ofertues, për realizimin me sukses kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 2 (dy) – persona që të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajn e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, ku nga këta 1(një) duhet të jetë shoferë i pajisur me lejen e drejtimit, si dhe 1 (një) punonjës ndihmës, për shpërndarjen e mallrave në ambjentet e caktuara prej autoritetit kontraktor. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit nuk është në proporcion me objektin e prokurimit “Blerje materiale pastrimi”.

Për sa më sipër Komisioni gjykon se pas shqyrtimit të dokumentave standarte të tenderit, vlerëson se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues, për realizimin me sukses kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 2 (dy) – persona që të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajn e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, ku nga këta 1(një) duhet të jetë shoferë i pajisur me lejen e drejtimit, si dhe 1 (një) punonjës ndihmës, për shpërndarjen e mallrave në ambjentet e caktuara prej autoritetit kontraktor për zgjedhjen e ofertuesit, nuk është në proporcion me objektin e prokurimit, i cili përfshin furnizimin me “Blerje materiale pastrimi”. Kriteri i aplikuar nga autoriteti kontraktor i tejkalon nevojat reale të kontratës dhe nuk reflekton kompleksitetin apo vlerën e objektit të prokurimit, duke krijuar një mundësi të padrejtë diskriminimi ose pengim të konkurrencës së barabartë midis ofertuesve. Për rrjedhojë, kriteri i parashikuar duhet të rishikohet dhe të përshtatet në mënyrë të arsyeshme me nevojat reale të kontratës, në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe konkurrencës së lirë, si dhe në respekt të LPP.*

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qëndron.

III. 3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “MIA Group Albania” SHPK , me arsyen se

...[3-Te hiqet kriteri 2.3.4 OE te kete mjet transporti ATP dhe të shoqëruar me lejen higjeno-sanitare. Ne si kompani e shikojme te pa baze dhe tejet abuziv kete kriter te ngritur nga AK. Theksojme se ne nuk jemi kunder qe OE te kene makineri transporti te dokumentuar patjeter por e gjeme te pa baze qe te kerkohen leje higjono-sanitare per automjetet dhe automjet ATP. Theksojme se automjetet ATP jane automjete frigoriferike qe cilat perdoren per transportin e mallrave ushqimore si mish, bulmet etj ku tek kjo procedure nuk kemi te bejme me mallra ushqimore, se ska ca ti prishet leckave, fshesave dhe detergjenteve gjate transportit. Pra nese shikojme me poshte se cfare eshte ATP ne teresi kuptojme qe ky kriter eshte jo vetem abuzif por dhe qellimisht kerkohet paracaktimi i fitusit te kesaj procedure. Me poshte gjeni njoftimin e DPSHTRR. DPSHTRR njofton Me anë të këtij aplikimi subjekti pajiset me dokumentin nëpërmjet të cilit autoriteti kompetent certifikon zyrtarisht që miratohet një pajisje izotermike, ngrirëse, frigoriferike ose kaloriferike për transport ndërkombëtar rrugor të ushqimeve delikate, në përputhje me standardet e marrëveshjes ATP .Llojet e automjeteve Testet janë teste laboratorike që duhet të kryhen tek prodhuesi i mjetit dhe nuk mund të kryhen nga përdoruesi. Transporti ndërkombëtar i produkteve të prishura sipas Konventës ATP kërkon që automjeti të ketë një certifikatë të vlefshme ATP. Për të marrë këtë certifikatë, duhet të testohet një lloj i automjetit. Mjeti që do të testohet duhet të jetë çdo mjet i përzgjedhur nga prodhimi në masë. Gjëja kryesore në certifikimin ATP është zona e kutisë më të ftohtë, që quhet superstrukturë.]...

III .3.1. Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.4 Shtojca 7 “ Kriteret e vecanta”, ka parashikuar kriterin si në vijim:

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë të paktën 1 (nje) mjet ATP për transportin e materialeve të pastrimit të cilin duhet ta ketë në pronësi apo të marrë me qira, të këtë vërtetuar me dokumentacionin përkatës (çertifikatë pronësie ose kontratë qeraje noteriale) dhe të shoqëruar me lejen higjeno-sanitare, leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit) .

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

III.3.2. Në nenin 77, pikat 2 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1 Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.3.3. Referuar Nenit 40 “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 1 dhe pika 5, të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet: *1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave. 5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që*

ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

III.3.4 Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse për sa i përket rastit konkret, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.3.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë, se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Komisioni vëren, se synimi bazë i autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi është sigurimi i mallrave objekt-prokurimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe realizimin me sukses të kontratës. Referuar testit të proporcionalitetit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se këto kërkesa nuk duhet të jenë kufizuese dhe se kriteri i vendosur nuk është në proporcion me natyrën, objektin e kontratës, sasinë e mallrave objekt prokurimi, ndaj dhe autoriteti kontraktor duhet të kryejë modifikimin të DST me qëllim për të zgjeruar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi.

Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Në rastin konkret, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes, Komisioni vëren se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë sipas pikës 2.3.4 *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë të paktën 1 (nje) mjet ATP për transportin e materialeve të pastrimit të cilin duhet ta ketë në pronësi apo të marrë me qira, të këtë vërtetuar me dokumentacionin përkatës (çertifikatë pronësie ose kontratë qeraje noteriale) dhe të shoqëruar me lejen higjieno-sanitare, leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit* .

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se këto

kërkesa nuk duhet të jenë kufizuese dhe se kriteri 2.3.4, nuk është në proporcion me natyrën, objektin e kontratës sasinë dhe fondin limit, ndaj dhe autoriteti kontraktor duhet të kryejë modifikime të kriterëve kualifikuese sa më sipër cituar, për të zgjeruar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Përsa argumentuar më sipër Komisioni gjykon se përmbushja e kriterëve kualifikuese, përsa i përket kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim, autoriteti kontraktor me kriteret e kërkuara ka rënduar pozitën e operatorëve ekonomikë në tërësi dhe të përfaësuese të biznesit të mesëm dhe të vogël. Sa më sipër, në analizë të llojit të procedurës së prokurimit e konkretisht “procedurë e hapur e thjeshtuar” si edhe të elementeve të tjera të procedurës së prokurimit, ku legjislacioni parashikon që autoritet/entet kontraktore duhet të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në frymën e ligjit, duhet të marrë masa për të hequr kriterin 2.3.4 mbi *disponimin të paktën 1 (nje) mjet ATP për transportin e materialeve të pastrimit të cilin duhet ta ketë në pronësi apo të marrë me qira, të këtë vërtetuar me dokumentacionin përkatës (çertifikatë pronësie ose kontratë qeraje noteriale) dhe të shoqëruar me lejen higjieno-sanitare, leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit për operatorët ekonomik.*

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “MIA Group Albania” SHPK , me arsyen se:

...4- Kerkojem heqjen e kriterit 2.5.1 si kriter I tepruar qe kerkon te cungoje sa me shume pjesmarjen e konkurences te paster dhe te lire midis Operatoreve Ekonomik. Duke pare kriterin me siper ku thuhet, Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë Magazine për depozitimin e mallit e cila duhet të jetë në pronësi/me qera ose në përdorim sipas kontratës noteriale, ku sipërfaqje totale për ambjentin të jetë jo më pak se 50 m² të pajisur me: -Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri te vlefshme ne kohen e zhvillimit te procedures. -Akt-miratim higjieno sanitar -Çertifikatën e dezinfektimit 3D - Si dhe foto të ambjenteve të ushtrimit të aktivitetit. Ne si OE nuk kemi pse te pajisemi me gjith kto licensa apo dokumenta qe nuk perkojne me mbarvajtjen e procedures. ?Te kete ne pronesi/qera magazine jo me pak se 50 m² ?Certifikate mbrojtje nga zjarri ?AKT-miratim higjieno sanitar ?Certifikate dezinfektimi 3D Kerkojme heqjen e ketij kriteri sepse ne mund ti marim mallrat brenda standarteve te cilesise dhe specifikimeve teknike nga Distributore te ndryshem sikunder kerkon AK, qofte edhe nga Inporti mallra te cilat mund te jene jashtezakonisht cilesore nga vende te Komunitetit European apo dhe nga prodhues Shqiptare. Ne nuk kemi pse ti ngarkojme vehtes keto kriteret cka i shikojme te pa vend dhe te jashteligjshme ndaj kerkojme nga KPP heqjen e ketij kriteri si jashte zakonisht abuziv.

III.4.1 Autoriteti Kontraktor në pikën 2.5.1 Shtojca 7 “ Kriteret e vecanta”, ka parashikuar kriterin si në vijim:

2.5 Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin:

2.5.1 Magazine për depozitimin e mallit e cila duhet të jetë në pronësi/me qera ose në përdorim sipas kontratës noteriale, ku sipërfaqje totale për ambjentin të jetë jo më pak se 50 m² të pajisur me:

- Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri te vlefshme ne kohen e zhvillimit te procedures.

- Akt-miratim higjeno sanitar
- Çertifikatën e dezinfektimit 3D
- Si dhe foto të ambjenteve të ushtrimit të aktivitetit.

2.6 Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin nga një mostër të produkteve të kërkuara për t'i krahasuar ato me specifikimet teknike për produktet e pastrimit .

- **Dorëzimi i mostrave do të bëhet ditën e hapjes së tenderit deri në orën 09 : ⁰⁰.**
Mosparaqitja e mostrave është kusht skualifikimi.

III.4.2. Komisioni vlerëson se referuar pretendimit së operatorit ekonomik si dhe shqyrtimit të kriterit të përcaktuar në pikën 2.5.1 të dokumentacionit të prokurimit, konstatohet se kërkesa që operatori ekonomik duhet të disponojnë, *2.5.1 Magazine për depozitimin e mallit e cila duhet të jetë në pronësi/me qera ose në përdorim sipas kontratës noteriale, ku sipërfaqje totale për ambientin të jetë jo më pak se 50 m² të pajisur me: Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri te vlefshme ne kohen e zhvillimit te procedures.Akt-miratim higjeno sanitar Çertifikatën e dezinfektimit 3D*, Komisioni vlerëson se ky standard i kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk ka karakter proporcional duke ju referuar kjo e fundit objektit të prokurimit dhe shton barrë administrative dhe financiare të paarsyeshme mbi ofertuesit, duke kufizuar potencialisht konkurrencën e lirë dhe të barabartë, në kundërshtim me parimet themelore të ligjit për prokurimin publik, përfshirë proporcionalitetin, transparencën dhe objektivitetin e procedurës.

Në këto kushte duke qenë se kriteri nuk reflekton kompleksitetin apo vlerën reale të kontratës dhe mund të favorizojë në mënyrë të padrejtë subjekte të caktuara, Komisioni gjykon se kriteri i parashikuar nuk siguron një proces prokurimi të drejtë dhe të barabartë dhe cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë parimin e konkurrencës së lirë ndaj duhet të hiqet.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen, për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “MIA Group Albania” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF- 82530-04-20-2026, me objekt: “Blerje Materiale Pastrimi” me fond limit 3,327,400.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 04-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Kuçovë

2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “MIA Group Albania” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF- 82530-04-20-2026, me objekt: “Blerje Materiale Pastrimi” me fond limit 3,327,400.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 04-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Kuçovë

3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, dhe vendimit të KSHA si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.

4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MIA Group Albania” SHPK

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

